



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 160 dt.10.10.1996

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.10.10.1996, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Propozim për kalim në fond banese”, në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

VENDOSI

1. Të miratojë kalimin në fond banese të objektit godinë 3 katëshe e ish konviktit të shkollës së ulët të kursit një vjeçar të industrisë që ndodhet në rrugën “Haki Stërmilli” pranë ish kombinatit të tekstileve.
2. Seksioni i Strehimit të Bashkisë në bashkëpunim me Njësinë Administrative Nr.6 konform dispozitave ligjore në fuqi në fuqi të pregatisin materialin përkatës për të gjithë banorët që jetojnë aty dhe ta paraqesin në Këshill Bashkiak për miratim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Seksioni i Strehimit të Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA